

KOMITETI DREJTUES

Nr. 60 Prot.

Tiranë, 18 Shtator 2023

Vendim Nr. 6 i KD-së

Komiteti Drejtues i FSHB-së në mbledhjen më datë 15 shtator 2023, drejtuar nga Presidenti, Z. Avni Ponari dhe prezencë të anëtarëve, Znj. Edera Alibegaj, Znj. Migena Plasa, Z. Dritan Mema, Z. Blendi Dibra dhe Z. Klevis Kaso, duke formuar kuorumin e domosdoshëm për zhvillimin e mbledhjes, diskutuan mbi rendin e ditës si vijon:

1. Pjesëmarrjet e shoqatave anëtare në kampionatet kombëtare 2023-24;
2. Kërkesat e shoqatave të reja për anëtarësim në FSHB;
3. Organizimi i Kupës së Federatës 2023 (M-F);
4. Organizimi i Jr.NBA Albania 2023;
5. Raport i pjesëmarrjeve me ekipet kombëtare të moshave U20/18/16 Djem dhe U18/16 Vajza 2023;
6. Të ndryshme.

Komiteti Drejtues diskutoi sipas rendit të ditës duke trajtuar problematikat për secilin kampionat kombëtar të rritur/a.

U trajtuan të gjitha kërkesat e shoqatave të interesuara për anëtarësim në Federatën Shqiptare të Basketbollit duke analizuar problematikat një nga një sipas Statutit të FSHB-së, si dhe konform ligjit të sportit për Federatat Kombëtare.

U rakordua zhvillimi i Kupës së Federatës 2023 (M-F).

U diskutua draft projekti për Jr.NBA Albania 2023 duke zbatuar marrëveshjen e bashkëpunimit me organizatën e Jr.NBA.

Në përfundim, Komiteti Drejtues analizoj raportimet e aktiviteteve dhe raportet financiare përkatëse të ekipeve kombëtare gjatë verës 2023, si dhe trajtoi çështje të ndryshme.

Për sa më sipër KD-ja vendosi:

1. Fillimin e kampionateve kombëtare të rritur/a 2023-24.
U përcaktua data e shortit, 2 tetor 2023, si dhe data e fillimit të kampionateve, 6 - 7 tetor.

Ekipet pjesëmarrëse në këto kategori duhet të kryejnë plotësimin e të gjithë dokumentacioneve, si dhe duhet të kryejnë të gjitha detyrimet financiare që rrjedhin nga pjesëmarrja në aktivitet në përputhje me rregulloren për këtë qëllim.

2. U përcaktuan shoqatat që fitojnë statusin e kandidatit për anëtarësim në FSHB.
Ju lë detyrë shoqatave që nuk i kanë përmbushur kushtet për këtë status, të plotësojnë në vijim dokumentat e tyre në përputhje me Statutin e FSHB-së, si dhe me ligjin e sportit nr. 79, datë 27.04.2017 i rinovuar.

Fitojnë statusin e kandidatit deri në miratimin e tyre në Asamblen e rradhës:

- Shoqata “Elite Basket”;
- Shoqata “Leaders”;
- Shoqata “Royal Basket”
- Shoqëria “Akademia e Basketbollit Durrës”;
- Shoqata “Skampa Basket Elbasan”.

Lejohen të marrin pjesë në edicionin 2023-24, duke qënë në pritje të dokumentacionit të plotë në përputhje me Statutin e FSHB-së dhe ligjin e sportit:

- Shoqata “Pogradeci Basket”;
- Shoqata “Juvenilia Basket Academy”;
- Shoqata “Barleti”;
- Shoqata “Akademia 109 Tirona”.

3. Organizimi i Kupës së Federatës 2023 (M-F) në datat 25 deri më 29 shtator 2023, në p.s. Dhimitraq Goga, Durrës;
4. Organizimi i Jr.NBA Albania 2023 sipas draft projektit të paraqitur duke zbatuar kërkesat e marrëveshjes me organizatën Jr.NBA;
5. Miratim i raporteve financiare të aktiviteteve për ekipet kombëtare të moshave U20/18/16 Djem dhe U18/16 Vajza 2023;
6. Të ndryshme:
 - Shpallja e pritjes së aplikimeve deri më 30 tetor 2023 për trajner të ekipeve kombëtare të moshave për aktivitetet e verës 2024;
 - Shpërbtim në vlerën 10'000 lek neto për secilin anëtarë të KD-së pjesëmarrës në mbledhjet e organizuara konform Statutit të FSHB-së;
 - Blerja e një aparati fotografik për përdorim gjatë aktiviteteve të organizuara nga FSHB.